



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E POLITIKAVE DHE ZHVILLIMIT
TË INDUSTRIËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN
E MINIERAVE DHE INDUSTRIËS**

Nr. 3501/2 Prot.

Tiranë, më 18.05.2022

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1615, datë 07.03.2013.

**SHOQËRISË “MINERALUNIT” SH.P.K
Rrajcë, Bashkia Librazhd, Qarku Elbasan.**

**Për djeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “MINERALUNIT” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1615, datë 07.03.2013, për mineralin Krom, në Objektivin “Bregu i Tollovcës”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr.1928, datë 27.04.2022, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr.3501, Prot, datë 28.04.2022, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1615, datë 07.03.2013, për mineralin Hekur-Nikel, në Objektivin “Bregu i Tollovcës”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar lidhur me ndërprerjen e aktivitetit minerar, ku rezulton se në objekt nuk është punuar prej më shumë se një viti kalendarik.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “c” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit Nr.1615, datë 07.03.2013, për mineralin Krom, në Objektivin “Bregu i Tollovcës”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë që shoqëria Juaj zotëron.**

Ju bëjmë me dije se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1615, datë 07.03.2013, për mineralin Krom, në Objektivin “Bregu i Tollovicës”, Bashkia Pogradec, Qarku Korçë.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

MINISTRI
BELINDA BALLUKU
ME AUTORIZIM
ZËVENDËSMINISTRI
ILIR BEJTJA

